



REPUBLIKA E KOSOVËS

/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICË /OPŠTINSKI SUD U MITROVICI/ MUNICIPAL COURT IN MITROVICA

C.nr 215/2010

GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesve; I dhe Nderhyresi ne anen e paditesve; i nga Mitrovica te cilet i perfaqson Avokat; i nga Mitrovica, sipas autorizimeve me shkrim, kunder te paditurit; nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqson Avokat; nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaje gjykate, baza e kontestit; Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit; 800,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.12.05.2011, jep kete;

AKTGJYKIM

I- APROVOHET kerkespadia e paditesve dhe VERTETOHET me sa vijon;

-Paditesi; I nga Mitrovica eshte pronar i palujtshmeris, pjeses se parc.kat.3584 me kultur, are, klases 6 ne vendin e qujtur Zveqani i Vogel me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe, S-931m2, sipas qertifikates se pronesise nr. 3904 Zk-Mitrovice e qe evidentohet ne emer te paditurit;Shaban Idriz 1/1.

-Paditesi; nga Mitrovica esht pronar i palujtshmerise, pjeses se parc.kat. 3584, me kultu are, klase 6 ne vendin e qujtur Zveqani i Vogel me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe prej S-930m2, sipas qertifikates se pronsise nr.3904 Zk Mitrovice e qe evidentohet ne emer te paditurit; Shaban Idriz 1/1..

-Paditesi; nga Mitrovica eshte pronar i palujtshmeris, pjeses se parc.kat.3584me kulture are, klases 6, ne vendin e qujtur Zveqani i Vogel me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe S-1377m2, sipas qertifikates se pronsis nr.3904 ZK Mitrovice e qe evidentohet ne emer te paditurit; Shaban Idriz 1/1.



-Paditesi; / nga Mitrovica eshte pronar i palujtshmeris, pjeses se parc.kat. 3584 me kultur are klases 6, ne vendin e qujtur Zveqani i Vogel me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe S- 316m², sipas qertifikates se pronsise nr. 3904 ZK Mitrovice e qe evidentohet ne emer te paditurit; Shaban Idriz 1/1.

-Paditesi; / nga Mitrovica eshte pronar i palujtshmerise, pjeses se parc.kat. 3584 me kultur are, klases 6, ne vendin e qujtur, Zveqani i Vogel, me masat she kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne siperfaqe S- 500m², sipas qertifikates se pronsise nr. 3904 ZK Mitrovice e qe evidentohet ne emer te paditurit; Shaban Idriz 1/1.

II- DETYROHET i padituri qe te iu njohe kete te drejte paditesve dhe ti lejoje qe paditesit kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovice, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

III- Obligohen paditesit qe Perfaqsesit te perkohshem te paditurit ti paguajne ne menyre solidare, shumen prej 202,80 Euro, ne afati n prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditesit ne padit e tyre te parashtruara si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se te njejtit para 25 viteve i kane blere palujtshmerit e cekura ne dispozitiv dhe qe nga momenti i shitblerjes paditesit sbashku me familjet e tyre kan hyre ne posedim te prones, ku te njejtit ne vazhdimesi e kane shfrytzuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese. Paditesit tani vone kane kuptuar qe palujtshmeria e cila eshte ne posedim faktik te tyre qe nga blerja e saje nuk evidentohet ne emrin etyre, andaj kane interes juridik qe kjo palujtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emerin e tyre.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohr i propozojne gjykates qe te i caktoi perfaqsesin e perkohshem.

Nderhyresi; / parashtroi kerkese me shkrim qe te nderhyjne ne kete konteste ne anen e paditesve nga se ka interes juridik per ti mbeshtetur paditesit.

Gjykata aprovoi pjesmarrjen e nderhyresit ne anen e paditesve, konform nen.271 dhe 272.3 te LPK.

I autorizuari i paditesve dhe nderhyresit ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padite dhe precizimin e kerkespadive te paditesve ti aprovoi si te bazuara nga se paditesit e kane fitar kete prone ne baze te mbajtjes me mirbesim me shume se 20 vite e kane shfrytzuar panderprer e ne kuptim te nen.40 te Ligjit per pronsine dhe te drejtat tjera sendore.

Shpenzimet e procedures kontestive i kerkoj



Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesve e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr.215 /2010 dt 17.03.2011 te padituri i caktoi Perfaqsesin e perkohshem, Avokat . cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Perfaqsesi i perkohshem i te padituri ne pergjigje te padive dhe precizimit te kerkespadive te paditesve deklaroi; fillimisht i kontestoi padite dhe kerkespadit, ndersa pas administrimit te provave ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe ne baze te vlersimit real te provave te nxjerrura te bie vendim meritor.

Shpenzimet e perocedures kontestmore i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Qertifikaten mbi pronesin, Ul 71208072-03904 te dt.13.10.2010 ne emer te padituri, lexoi ekspertizat gjeodete te ekspertve gjeodet; dhe te datave 01.03.2011, beri veshtrimin ne Skicat e terenit, ndegjoi deshmitaret; dhe , si dhe ndegjoi paditesit; I dhe Asllan Istrefi ne cilesi te paleve dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga Qertifikata mbi te drejtat e pronesc se palujtshme te cekur me larte konstatohet se parc. kat.03904, Zk-Mitrovice, evidentohen ne emer te padituri.

Nga konstatimi dhe mendimi i Ekspereve gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerive nga ana e eksperteve gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, kane vertetuar se palujtshmerite kontestuese bine -gjegjesishte e perbejne pjeset e parc. te cekura me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizat e dhena me shkrime dhe skicat e terenit te cilat jane pjese perberse te ketyre ekspertizave dhe te aprovura si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Deshmitari deklaroi; dhe nga i padituri paten bler troje dhe ate Musliu 15 ari dhe Muja 10 ari. Edhe une pata bler truall atu afer ne vitin 1986 dhe kur ka shkuar kta veq kishin qene tu i ndertu shtepit ku jan vendosur me familje dhe nga ajo kohe i kane shfrytzuar kto palujtshmeri pa kurfare pengese gjere ne fillimin e luftes ne Kosove me qraste i jane shkatrruar keto shtepi gjate luftes. E dine qe ne tersi e kane paguar qmimin e shitblerjes...Kto rrethana deshmitari i di sepse i njejti ka palujtshmeri te tije atu ne afersi.

Deshmitari deklaroi se Paditesit diku ne Pranveren e vit 1986 nga i padituri paten bler trojet tani lendore ku edhe ky deshmitar i ka bler nga i padituri 15 ari truall. Shitblerja eshte bere me marrveshje dhe kontratin terme me shkrim te cilat i kane perpiuar te Av



kundervler te Euros diku rreth 700-800 euro. Ne tersi eshte paguar qmimi i shitblerjes, sepse pa i pagur shitsi nuk i ka lejuar te ndertojn asgje. Te gjith paditesit paten ndertuar shtepi me perjashtim te i cili pat vu themelin dhe 1 -garazhe. Kto shtepi dhe objekte jane shkatrru gjat luftes.

Deshmitari . . . , deklaroi se Paditesat; diku ne vit 1985-86 i kane bler trojet tani lendore nga i padituri me qrast edhe ky ka bler truall, 7 ari atu afer nga 1 Serb. Shitblerja eshte ber sipas Kontratave interne , qmimi ka qene ne dinare dhe se ne tersi paditsat e kane paguar qmimin e shiblerjes. Paditesit ne keto troje kane ndertuar shtepit per banim ku sbashku me antaret e familjes kane jetuar gjer ne fillimin e luftes te cilat iu jan djegur gjat luftes.. Kto palujtshmeri paditesit i kane shfrytzuar pa pengesa.

Paditesi i . . . ne cilsu te pales deklaroi; Ne Pranveren e vit. 1986 nga i padituri ka bler 10 ari truall me qmim ne dinar diku ne kundervler te sotme rreth 800 Euro per ari. Shitblerja eshte bere sipas marrveshjes gojore, ne tersi e ka paguar qmimin e shitblerjes me rastin e shitblerjes dhe ne vit 1989 ka ndertuar edhe shtepin 3 katshe per banim, eshte vendos me antaret e families dhe ka shfrytzu pa kurfar pengese gjere ne fillimin e luftes ne Kosove ne vit 1999, me qrast i eshte djegur dhe shkatrruar. Gjithashtu edhe padiesit tjer -aktual nga i padituri paten bler troje nga i padituri, kan ndertu shtepit per banim me perjashtim te .

Paditesi i . . . deklaroi, ne Pranveren e vit 1986 nga i padituri ka bler 16 ari truall me qmim ne dinare ne kundrvler te sodit diku reth 800 euro ari. Shitblerja eshte ber sipas marrveshes gojore, ne tansi e ka paguar qmimin e shitblerjes dhe meniher ka fillu ndertimin e shtepis dhe ka ndertu shtepi 3- atshe te cilen e ka shfrytzu sbashku me antaret e familjes pa kurfar pengesash gjer ne fillimin e luftes me qrast kjo shtpi i eshte djegur ne tersi. Ne afersi te tije paten ndertu shtepit e tyre edhe paditesit aktual.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore e kane blere paditesit , sipas kontratave interne me shkrim dhe marrveshjeve gojore mbi shitblerjen ne vitin 1986-, me qmim te shitblerjes ne dinare, tani shprehur ne Euro, diku rreth 800 euro, per ari te cilin qmim ne tersi ia kane paguar te paditurit ne cilesi te shitesit i cili menjeher iu ka lene ne disponim dhe shfrytzim te lire kto palujtshmeri- bleresve , tani paditesve te cilet se bashku me antaret e familjes se tyre i kane shfrytzuar pa pengesa qe nga momenti i shitblerjes e gjer ne vitin 1999- luftese ne Kosove. Ndersa pase kesaje posedimi eshte i kufizuar per shkaqe te njohura ne kete pjese- veriore te Mitrovices.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronetin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronetin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes , paditesit e kane pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtra me mirbesim; koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i ketyre palujtshmeri.



Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesit keto palujtsheri i kane blere nga pronari i saje qka vertetohet nga fleta poseduse ne emer te paditurit.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekziston sepse paditesit i kane blere keto palujtshmeri nga i paditeuri , qysh nga vitet 1986.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesit kane hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te ketyre palujtshmerive te tyre, gjer me tani. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesve ne menyre- derivative- me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450, 453.1 dhe 459.1 te LPK. Duke i njohur shperblimin e Perfaqsesit te perkohshem te paditurit per pesmarrije ne 2- seanca, shumen prej nga 101.40 euro, konform nen 7 te TA.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA KMUNALE NE MITROVICE

C nr 215/2010 dt.12.05.2010



Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketije aktgjykimi kane te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Qarkut ne Mitrovice e permes kesaje gjykate.

Saktsin e pershkrimitt e verteton;